



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PPROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2023

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.166 DATË  
16.12.2004 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”.**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr.166 datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

1. Titulli i nenit 65/1 riformulohet: “Masat disiplinore“përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare” deri në 10 ditë, 30 ditë, apo 60 ditë”.

2. Në nenin 65/1 shtohen pikat 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“6. Masa disiplinore“ përjashtim nga pjesëmarrja në komisione/në seancë plenare” deri në 30 ditë” jepet në rastet:

- a) kur deputeti përdor dhunë fizike ndaj deputetëve të tjerë, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, punonjësve të shërbimit të seancave apo të Gardës së Republikës.
- b) kur deputeti përmes veprimeve të dhunshme dëmton pajisjet dhe orenditë e cdo mjet tjetër logjistik në sallën e seancave/mbledhjes.
- c) kur deputeti kryen në mënyrë të përsëritur brenda një sesioni parlamentar shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”

“7. Masa disiplinore “përrjashtim nga pjesëmarrja në komisione /në seancë plenare “ deri në 60 ditë jepet në rastet :

- a) kur deputeti përdor lëndë apo mjete piroteknike, tymuese, bojra dhe materiale apo mjete të tjera të ngjashme brenda sallës së zhvillimit të punimeve të Kuvendit/mbledhjes së komisionit / brenda mjediseve të Kuvendit;
- b) kur deputeti kryen veprime / sjellje që përbëjnë shkeje që konfigurohen si shkelje penale pavarësisht nëse shkelja përben vepër penale sipas Kodit Penal;
- c) kur deputeti kryen në mënyrë të përsëritur brenda një sesioni parlamentar shkeljet e parashikuara në pikën 6.”

8. Kërkesa për marrjen e masës disiplinore, sipas pikave 6 dhe 7 të këtij neni, paraqitet me shkrim nga jo më pak se 7 deputetë dhe jo më vonë se 48 orë nga dita e konstatimit të ngjarjeve/ rasteve.

9. Gjatë periudhës së zbatimit të masës disiplinore të parashikuar në pikat 6 dhe 7 të këtij neni deputeti ndalohet të kryej dhe çdo veprimtari tjetër si anëtar i Kuvendit.

## **Neni 2**

Neni 65/2 pikat 1, 4 dhe 5 dhe riformulohen me këtë përmbajtje:

1. “1. Masat disiplinore “përrjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe/ose në seancë plenare” jepet nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Mbledhja e Sekretariatit zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës.”

2. “5. Vendimi i dhënë për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronjat “a” dhe b”, pikën 6 dhe 7 të neni 65/1, publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Për rastet e parashikuara në pikën 1, shkronja “c”, të neni 65/1 publikimi bëhet vetëm me pëlqimin e personit/viktimë e ngacimit seksual.”

### **Neni 3**

Në Nenin 65/3 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 4 pas fjalës pezullohet shtohet togëfjalshi “me vendim të ndërmjetëm të Byrosë së Kuvendit, deri në dhënien e vendimit përfundimtar”.
2. Pika 5 shfuqizohet.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**

**LINDITA NIKOLLA**

Miraturar, më datë \_\_\_\_\_ 2023